



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 89, datë 17.06.2019

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM DHE SHPALLJEN E DY POZICIONEVE TË LIRA PËR TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, duke patur në konsideratë edhe vendimin nr.47, date 13.06.2018, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Mbi transferimin e përkohshëm të Gjyqtarëve në disa Gjykata”, i cili ndër të tjera, ka vendosur transferimin e përkohshëm për 1 (një) vit, edhe të dy gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Të shpallë dy pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për transferim të përkohshëm deri në një vit.
2. Thirrja për transferim t’i drejtohet gjyqtarëve të transferuar aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, të cilët ftohen për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.
3. Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm të jetë 3 ditë, duke filluar nga dita e publikimit të thirrjes në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
4. Ngarkohet Komisioni për Zhvillimin e Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR